

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, BASHKIA LEZHË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Lezhë, me objekt “Mbi realizimin e të ardhurave vendore dhe zbatimin e legjislacionit për programimin dhe vjeljen e taksave e tarifave vendore” për periudhën 01.01.2013 – 30.6.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 177, date 23.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 965/7, datë 23.12.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar z. Viktor Tusha Kryetar i Bashkisë, Lezhë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Nga analiza mbi të ardhurat e realizuara në periudhën 01.01.2013 – 30.6.2014, sipas zërave të miratuar me VKB rezultoi se:

-Të ardhurat në total nuk janë arkëtuar në shumën 122,413 mijë lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Lezhë, kjo si rezultat i mos zbatimit të përgjegjësive funksionale nga Drejtoria e të Ardhurave dhe mungesës së bashkëpunimit ndërmjet drejtorive të ngarkuara për mbledhjen e të ardhurave vendore, *trajtuar më hollësisht në faqet 14-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar* Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Lezhë të marrë masa konkrete për përmirësimin dhe organizimin e funksioneve si dhe të rritë bashkëpunimin me të gjitha drejtoritë pranë bashkisë që kanë detyrim ndjekjen dhe arkëtimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, duke rritur efektivitetin dhe efikasitetin e punës kontrolluese në terren dhe mirëmenaxhimin e borxhit nëpërmjet programeve të punës periodike.

### ***Menjëherë***

-Të ardhurat nga taksa e pasurisë së paluajtshme; për (ndërtesa) objekte në përdorim të biznesit dhe për (banesa) familjare nuk janë arkëtuar në shumën 19,927 mijë lekë dhe të ardhurat nga tarifave vendore për (*pastrim, ndriçim, gjelbërim*) të qytetit nuk janë arkëtuar në shumën 37,808 mijë lekë, në total 57,735 mijë lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Lezhë, kjo si rezultat i administrimit jo efektiv pasi nuk janë evidentuar dhe mbajtur të dhënat për pasuritë e paluajtshme në regjistra manual apo elektronik, *trajtuar më hollësisht në faqet 14-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar* Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Lezhë të marrë masa për sigurimin e të dhënave të domosdoshme nga ZVRPP, apo nëpërmjet komisioneve të ngritura nga organet e pushtetit vendor për verifikimin e

pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor dhe përgatitjen e regjistrave bazë për evidentimin, llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga taksa e pasurisë së paluajtshme.

### *Në vijimësi*

2. Drejtoria e të Ardhurave nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të siguruar bashkëpunim sipas përcaktimeve ligjore me institucionet si ZVRPP, DRSHTRR, ALUIZNIN, DTR Lezhë, KESH, UKL në cilësinë e agjentëve tatimor me qëllim rritjen e arkëtitimit të detyrimeve, *trajtuar më hollësisht në faqet 38-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. **Për këtë është rekomanduar** Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Lezhë të propozojë dhe të kërkojë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak që të caktohen detyra konkrete dhe të ndërmerren hapa ligjor për nënshkrimin e marrëveshjeve të përbashkëta me agjentët tatimorë ZVRPP, DRSHTRR, ALUIZNI dhe DRT Lezhë, apo me agjentët tatimorë lokal KESH dhe UKL me qëllim që të sigurohet rritja e efektivitetit në realizimin e të ardhurave të programuara.

### *Menjëherë*

3. Nga auditimi i dokumentacionit në dosjet e subjekteve dhe në sistemin elektronik të administrimit të taksave dhe tarifave vendore rezultoi se sistemi vendos në mënyrë automatike gjobë subjekteve që nuk respektojnë afatin e pagesës në masën 25 % të detyrimit, pavarësisht nga numri i ditëve në shkelje të afatit, *trajtuar më hollësisht në faqet 22-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. **Për këtë është rekomanduar** Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Lezhë që në bazë të kontratës dhe marrëveshjes me subjektin “Datech” shpk i cili përgjigjet për suportin e programit të administrimit të taksave dhe tarifave vendore, të marrë masa për modifikimet e mundshme me qëllim që në rastet e mos likuidimit në afatin e përcaktuar të detyrimit, subjektet të mos penalizohen menjëherë në masën 25 % të detyrimit, por gjoba për pagesat e vonuara të jetë e diferencuar në masën 5 % në muaj, jo më shumë se 25 % të detyrimit, bazuar kjo në përcaktimet e nenit 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar.

### *Menjëherë*

4. Nga auditimi mbi detyrime të pa likuiduara rezultoi gjendje debitor (borxh), e pasqyruar në regjistrin dhe evidencën e mbajtur nga Drejtoria e të Ardhurave, në datë 31.12.2013 në shumën 26,741,139 lekë që i përkasin 7,464 subjekteve dhe në datë 30.06.2014 në shumën 51,411,858 lekë që i përkasin 13,568 subjekteve, *trajtuar më hollësisht në faqet 31-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. **Për këtë është rekomanduar** Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Lezhë që në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Bashkia Lezhë të marrin masa për njoftimet e subjekteve për detyrimet e pa likuiduara deri në datën 30.06.2014, sipas evidencës; nga 133 subjekte biznes i madh në vlerën 7,529,660 lekë, nga 208 subjekte biznes i vogël në vlerën 3,877,288 lekë dhe nga 13,673 subjektet familjare për dy vitet për taksën dhe tarifën familjare në

vlerën 40,004,909 lekë, në total detyrime të pa likuiduara në vlerën 51,411,858 lekë, të cilat duhet të evidentohen në pasqyrat financiare të bilancit të Institucionit.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Të kërkohen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **3,925,958 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Vlera prej **1,657,538 lekë**, nga subjektet e pa regjistruar, për detyrime të paarkëtuara për vitin 2013, e pasqyruar në aneksi nr. 1 dhe vlera prej **1,090,820 lekë** nga subjektet e pa regjistruar, për detyrime të paarkëtuara për vitin 2014, e pasqyruar në aneksi nr. 2 bashkëlidhur me Raportin Përfundimtar të Auditimit.
2. Vlera prej **1,177,600 lekë**, për detyrime të paarkëtuara për vitin 2014, të mbartur nga subjektet që janë të pa regjistruar nga viti 2013, e pasqyruar në aneksi nr. 3 bashkëlidhur me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

## **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Lezhë, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1, germa “b”, neni 57 të ligjit nr. 152/2013, të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda, të bëj klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse disiplinore, sipas nenit 59.2 të ligjit nr.152/2013:

*-Neni 58, germa “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për nëpunësit civil si më poshtë:*

1. [REDAKTUAR] me detyrë funksionale, ish përgjegjëse e sektorit të regjistrimit tatimor, licencimit, kontrollit dhe administrimit të terrenit, aktualisht me detyrë Drejtore e drejtorisë së të ardhurave.
2. [REDAKTUAR] me detyrë funksionale, specialist në sektorin e regjistrimit tatimor, licencimit, kontrollit dhe administrimit të terrenit.
3. [REDAKTUAR] me detyrë funksionale, specialist në sektorin e regjistrimit tatimor, licencimit, kontrollit dhe administrimit të terrenit.
4. [REDAKTUAR] me detyrë funksionale, specialist në sektorin e regjistrimit tatimor, licencimit, kontrollit dhe administrimit të terrenit.

Për mos zbatim të legjislacionit tatimor, lidhur me programimin dhe realizimin e të ardhurave nga zbatimi i nivelit të taksave dhe tarifave vendore, me të cilët janë mbajtur procesverbalet

përkatësisht nr. 1, datë 05.11.2014, nr. 2, 3 e 4, datë 10.11.2014 dhe nr. 5, datë 13.11.2014, të cilat janë trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit Vladimir Rizvani, p/grupi, Anesti Gjikal dhe Livan Hoxha, u mbikëqyr nga Kryeauditues z. Albert Thoma, më tej u shqyrtua nga Drejtor i Departamentit zj. Albana Agolli dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Luljeta Nano.

**Mbi zbatimin e rekomandimeve:**

Bashkia Lezhë nuk ka kthyer ende përgjigje për masat e marra në zbatim të rekomandimeve.

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**